



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Para: Gjykatësit të vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 29 tetor 2020

Gjuha: anglishte

Klasifikimi: Publike

Vendim për gjuhën e punës

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit për Hysni Gucatin
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit kujdestar për Nasim
Haradinajn**
Bastian Martens

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 8(3)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti kërkesë për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave përkatës për transferim kundër Hysni Gucatit (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) (bashkërisht “të dyshuarit”).²

2. Më 24 shtator 2020, gjykatësi i vetëm lëshoi fletarrestimet kundër të dyshuarve, si dhe urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).³

3. Më 25 shtator 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj u arrestuan në Kosovë⁴ dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së, përkatësisht më 25 dhe 25 shtator 2020.⁵

¹ KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Version publik i redaktuar dhe versioni konfidencial i redaktuar i kësaj kërkesë u protokolluan më 1 tetor 2020.

³ KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publike; KSC-BC-2020-07, F00016, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftimi për pranimin e Hysni Gucatit në objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publike, me shtojcën 1, konfidenciale; KSC-BC-

4. Më 29 shtator 2020 dhe 1 tetor 2020, z. Haradinaj dhe z. Gucati bënë paraqitjet e para (bashkërisht "Paraqitjet e Para").⁶

5. Më 30 shtator 2020, gjykatësi i vetëm urdhëroi palët që të paraqisnin parashtrime në lidhje me gjuhën e punës për këtë proces deri më 7 tetor 2020 ("Urdhri për parashtrime").⁷ Më 4 tetor dhe 7 tetor 2020, përkatësisht mbrojtësi i z. Gucati⁸ dhe ZPS-ja⁹ parashtruan se anglishtja duhet të jetë gjuha e punës. Më 9 tetor 2020, mbrojtësi i z. Haradinaj u pajtua me parashtrimet e palëve të tjera.¹⁰

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me nenin 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara ("DHS") janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja, dhe në çdo proces gjyqësor, një panel mund të caktojë gjuhët e punës për atë proces, siç është e përshtatshme dhe duke respektuar në tërësi të drejtat e të akuzuarve.

7. Në përputhje me rregullën 8(3)(a) të Rregullores, në varësi të nenit 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është

2020-07, F00020, Administratorja, *Njoftimi për pranimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-07, Transkriptim, 29 shtator 2020, publike; KSC-BC-2020-07, Transkriptim, 1 tetor 2020, publike.

⁷ KSC-BC-2020-07, F00035, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për parashtrime në lidhje me gjuhën e punës së procesit*, 30 shtator 2020, publik, para. 10.

⁸ KSC-BC-2020-07, F00041, Mbrojtja e Gucatit, *Parashtrimet në lidhje me gjuhën e punës së procesit* ("Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit për gjuhën e punës"), 4 tetor 2020, publike, paragrafët 1-3.

⁹ KSC-BC-2020-07, F00043, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimet e Prokurorisë për gjuhën e punës për KSC-BC-2020-07* ("Parashtrimet e ZPS-së për gjuhën e punës"), 7 tetor 2020, publike, paragrafët 2-6.

¹⁰ KSC-BC-2020-07, F00044, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrimet në lidhje me gjuhën e punës së procesit* ("Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt për gjuhën e punës"), 9 tetor 2020, publike, paragrafët 1-2. Mbrojtësi për z. Haradinaj i paraqiti këto parashtrime dy ditë pas afatit të caktuar nga gjykatësi i vetëm. Mbrojtësi nuk bëri kërkesë që përmbante arsye të vlefshme për gjykatësin e vetëm që ta zgjaste afatin sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, e as kërkesë që përmban arsye të vlefshme për gjykatësin e vetëm për të pranuar si të vlefshme parashtrimet e protokolluara pas përfundimit të afatit, sipas rregullës 9(5)(b) të Rregullores. Megjithatë, në këtë rast, gjykatësi i vetëm i pranon *proprio motu* parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt të datës 9 tetor 2020 si protokollime të vlefshme, sipas rregullës 9(5)(b) të Rregullores.

e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

III. DISKUTIM

A. PËRCAKTIMI I GJUHËS SË PUNËS

8. Neni 20 i Ligjit e lejon gjykatësin e vetëm që të miratojë vendim për gjuhën e punës në cilëndo "procedim". Siç është bërë e ditur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në KSC-BC-2020-05, derisa as Ligji e as Rregullorja nuk e përkufizojnë "procedimin", termi përkufizohet si "çështje gjyqësore në shqyrtim para një Dhome".¹¹ Duke pasur parasysh arrestimin, transferimin, dhe paraqitjen e parë të të dyshuarve, gjykatësi i vetëm e konsideron të nevojshme që të përcaktojë gjuhën e punës në procedimin aktual.

9. Siç është theksuar në urdhrin për parashtrime, përcaktimi i gjuhës së punës është i nevojshëm për të siguruar zhvillim të drejtë, efikas dhe të shpejtë të procedimit. Veçanërisht, kjo të do mundësojë përgatitjen dhe organizimin e parashtrimeve të palëve ose të pjesëmarrësve. Gjithashtu, kjo do të shtojë parashikueshmërinë dhe kapacitetin për planifikim të njëjësive të përkthimit brenda Zyrës Administrative dhe ZPS-së.¹²

10. Gjykatësi i vetëm thekson se gjuha e procedimit deri tani ka qenë anglishtja, meqenëse të gjitha parashtrimet nga ZPS-ja, Mbrojtja dhe Zyra Administrative, si dhe

¹¹ KSC-BC-2020-05, F00032, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për Gjuhën e Punës ("Vendim për gjuhën e punës në çështjen Mustafa")*, 8 tetor 2020, para. 10, citim nga ICC/GJPN-së, *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, ICC-01/04-556, Appeals Chamber Gjendja në Republikën Demokratike të Kongos, ICC-01/04-556, Dhoma e Apelit, [*Judgment on victim participation in the investigation stage of the proceedings in the appeal of the OPCD against the decision of Pre-Trial Chamber I of 7 dhjetor 2007 and in the appeals of the OPCD and the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I of 24 dhjetor 2007*](#), 19 dhjetor 2008, para. 45.

¹² Urdhër për parashtrime, para. 7; *Vendim për gjuhën e punës në çështjen Mustafa*, para. 11.

vendimet dhe urdhrat e gjykatësit të vetëm janë lëshuar në anglishte. Për më tepër, palët janë pajtuar që të vazhdojnë në këtë mënyrë.¹³

11. Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm përcakton që, për procedimin KSC-BC-2020-07, gjuha e punës të jetë anglishtja. Për këtë arsye, palët dhe pjesëmarrësit do t'i paraqesin parashtrimet në anglishte. Nëse shtojcat, materiali mbështetës ose provat e tjera në të cilat mbështeten palët ose pjesëmarrësit janë, në tërësi ose pjesërisht, në gjuhë të ndryshme nga anglishtja, duhet të bëhet përkthimi i këtyre materialeve në anglishte. Ky vendim nuk është i formës së prerë në lidhje me obligimet për përkthim sipas Ligjit dhe Rregullores.

B. ZBATIMI PRAKTIK

12. Për zbatimin praktik të përcaktimit të lartpërmendur, palëve dhe pjesëmarrësve u jepen udhëzimet e mëposhtme, sipas rrethanave.

- 1) *Rregull i përgjithshëm*: udhëzime para paraqitjes së parashtrimeve, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat; dhe
- 2) *Përjashtimet*: udhëzime pas paraqitjes së parashtrimeve, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat;

Në fund, përshkruhet procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me përkthimet.

1. Udhëzimet për fazën para paraqitjes së parashtrimeve

13. Palët dhe pjesëmarrësit kanë obligim që, në parim të veprojnë në përputhje me udhëzimet në vijim *para* paraqitjes së çfarëdo parashtrimi, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës apo provat e tjera.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtjes së Guccatit për gjuhën e punës, paragrafët 1-3; Parashtrimet e ZPS-së për gjuhën e punës, paragrafët 2-6; Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt, paragrafët 1-2.

14. Parashtrimet duhet të paraqiten në anglishte. Kur pjesë të tekstit, në pjesën kryesore të dokumentit ose në shënimet në fund të faqes, janë në një gjuhë tjetër nga anglishtja, duhet të jepet përkthimi në anglishte i këtyre pjesëve.

15. I njëjti kriter gjuhësor vlen për shtojcat, materialin mbështetës ose provat e tjera të paraqitura në të cilat mbështeten palët ose pjesëmarrësit. Kjo vlen për materialin e krijuar nga palët ose pjesëmarrësit, ose të mbledhur nga burime të tjera. Për të mbajtur në dokumentacionin e procesit vetëm materialet me rëndësi, nuk është e nevojshme që të paraqiten materialet e plota nëse palët ose pjesëmarrësit mbështeten vetëm në disa pjesë të tyre. Në rastet kur një dokument nuk mund të ndahet dhe pala ose pjesëmarrësi mbështetet vetëm në pjesë të caktuara të tij, duhet të shënohet pjesa, faqja, paragrafi ose fjalia konkrete në të cilën pala ose pjesëmarrësi mbështetet dhe duhet të jepet përkthimi në anglishte i pjesës në fjalë.

16. Sa u përket parashtrimeve, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës të paraqitur nga individë, autoritetet kosovare, shtetet e treta ose organizatat ndërkombëtare, vlejné këto kritere:

- (1) Një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës, paraqitur nga individë kosovarë ose autoritetet kosovare, mund të paraqitet në anglishte, shqipe ose serbishte;
- (2) Një parashtrim, përfshirë shtojcat dhe materialin mbështetës, paraqitur nga individë nga shtete të treta ose autoritetet e tyre, ose nga organizatat ndërkombëtare mund të paraqitet në anglishte ose në çdo gjuhë tjetër të zgjedhur ose gjuhë zyrtare;
- (3) Nëse një parashtrim, përfshirë shtojcat dhe materialin mbështetës, i adresohet panelit, ai shpërndahet nga Zyra Administrative. Është përgjegjësi e Zyrës Administrative që të sigurojë përkthimin në anglishte të çdo parashtrimi të protokolluar, përfshirë të shtojcave dhe të materialit të paraqitur në këtë mënyrë.

- (4) Nëse ZPS-ja paraqet një parashtrim që përfshin shtojca dhe material mbështetës të individëve, autoriteteve kosovare, shteteve të treta, ose organizatave ndërkombëtare, është përgjegjësi e saj të mundësojë përkthimin e tyre para se t'ia dorëzojë panelit.

17. Në rastin e audio/videomaterialeve ose materialeve në Internet, palët dhe pjesëmarrësit, sipas rastit, nuk mund të bazohen në atë material pa paraqitur transkriptimin e tij. Për materiale të tilla, duhet të sigurohen këto të dhëna:

- (1) sipas rastit, burimi relevant në internet dhe data e koha kur është parë për herë të fundit;
- (2) segmenti i saktë kohor ose fragmenti i tekstit, sipas rastit, në të cilin bazohet pala ose pjesëmarrësi, sipas rastit;
- (3) transkriptimi i fragmentit relevant në gjuhën origjinale, qoftë në parashtrimin kryesor të protokolluar apo në shtojcat e tij; dhe
- (4) nëse është paraqitur nga palët ose pjesëmarrësit, përkthimi në anglishte i fragmentit të transkriptuar.

18. Në parim, preferohen përkthimet e përgatitura nga përkthyes të kualifikuar, qoftë brenda Njesisë së Përkthimeve ("NJP"), qoftë nga shërbimi gjuhësor i ZPS-së. Sidoqoftë, gjykatësi i vetëm është i vetëdijshëm se, në raste të caktuara, si në raste urgjente ose kur përkthyesit e kualifikuar nuk janë në dispozicion, mund të pranohen edhe përkthime të tjera.

19. Siç parashihet në pjesën 4(2) të Udhëzuesit për përkthimet me shkrim dhe me gojë të Zyrës Administrative (KSC-BD-13) ("Udhëzuesi"), përkthimet e ofruara nga NJP-ja cilësohen si "version pune", "i vetëredaktuar" ose "zyrtar".

20. Kur përkthimi vjen nga ZPS-ja dhe është përgatitur nga përkthyes të kualifikuar ose nga personeli tjetër i kualifikuar, ai përkthim cilësohet si "Përkthim i ZPS-së". Kur përkthimi është përgatitur nga Mbrojtja, mbrojtësi i viktimave ose ndonjë pjesëmarrës tjetër, cilësohet si "Përkthim i Mbrojtjes", "Përkthim i mbrojtësit të viktimave", ose

“Përkthim i [emri i pjesëmarrësit]”. Kur përkthimi i dhënë nga palët ose pjesëmarrësit është përgatitur nga të tjerët, si për shembull një institucion gjyqësor tjetër ose përkthyes të jashtëm të pakualifikuar, ai nuk mund të mbajë cilësimet e lartpërmendura; përkundrazi, cilësimi i burimeve të jashtme mund të mbahet në dokument ose në materialin në fjalë. Cilësimi i drejtë i përkthimeve (ose mungesa e tyre) mbetet përgjegjësi e palëve dhe pjesëmarrësve. Është në kompetencën e brendaqenësishme të gjykatësit të vetëm që të kërkojë më vonë verifikimin nga NJP-ja të çdo përkthimi të bërë.

21. Çdo kërkesë për përkthim drejtuar NJP-së bëhet paraprakisht, në kohë të mjaftueshme dhe në pajtim me protokollet ekzistuese, për të mundësuar përkthim dhe korrigjim të duhur të elementeve të tekstit në fjalë.

22. Megjithëse ZPS-ja ka shërbimin e vet gjuhësor, ajo këshillohet që të koordinohet dhe të bashkëpunojë me NJP-në për çështjet e përkthimit, për të shpejtuar procedurat dhe për të maksimizuar efikasitetin.

2. Udhëzimet për fazën pas paraqitjes së parashtrimeve

23. Nëse një parashtrim i protokolluar, ose pjesë të tij, është paraqitur në një gjuhë tjetër nga anglishtja, Njësia për Administrimin Gjyqësor (“NJAGJ”) kërkon përkthimin e tij përmes sistemit elektronik të administrimit gjyqësor, *Legal Workflow* (“LWF”), në pajtim me pjesën 5(1)(b) të Udhëzuesit dhe pjesën 2(5) të Udhëzimit të Zyrës Administrative për Kërkesat për Shërbime për Përkthim me Shkrim e me Gojë dhe Verifikim (KSC-BD-14).

24. Nëse një shtojcë, material mbështetës ose provë tjetër përmban tekst në gjuhë tjetër nga anglishtja, pala ose pjesëmarrësi, sipas rastit, përcakton saktësisht çfarë dhe sa duhet përkthyer, duke saktësuar, sipas rastit, pjesën, faqen, paragrafin ose fjalinë relevante për t’u përkthyer, në LWF, në të njëjtën kohë kur paraqet dokumentin përkatës për protokollim në pajtim me pjesët 5(1)(b), 5(1)(d) dhe 5(3)(a) të Udhëzuesit.

25. Duke pasur parasysh pjesën 5(2) të Udhëzuesit, gjykatësi i vetëm e ruan të drejtën të kërkojë nga NJP-ja, përmes NJAGJ-së, që të përkthejë elementë të tekstit që kërkojnë përkthim zyrtar në anglishte në këto situata:

- (1) Në rastin kur pala ose pjesëmarrësi, sipas rastit, ka ofruar vetëm përkthimin e pacilësuar të elementëve përkatës të tekstit (shih paragrafin 20); ose
- (2) Në rastin kur nuk është kërkuar përkthimi i elementëve të tekstit të paraqitura në një gjuhë tjetër nga anglishtja, por të cilin gjykatësi i vetëm e vlerëson me rëndësi për zgjidhjen e kërkesës ose çështjes.

26. Vendimi i dhënë më lart nuk është i formës së prerë sa i përket obligimit të palës ose pjesëmarrësit për të paraqitur, nga fillimi, përkthimin në anglishte të çdo parashtrimi të protokolluar, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat e tjera¹⁴ ose, në raste të tjera, të përkufizojë shtrirjen e përkthimit të nevojshëm me saktësi.¹⁵

27. Duke reflektuar paragrafin 17 më lart, palëve ose pjesëmarrësve, sipas rastit, u sillen në vëmendje që të mos paraqesin audiomaterial, videomaterial ose material nga Interneti pa transkriptim përkatës. Në rastet kur nuk respektohen këto udhëzime, gjykatësi i vetëm ka të drejtë që ose:

- (1) të mos marrë parasysh referencat relevante në dokumentet e protokolluara, përfshirë shtojcat, ose materialin mbështetës ose provat; ose
- (2) të kërkojë nga pala ose pjesëmarrësi, sipas rastit, që të paraqesë korrigjim të dokumentit të protokolluar, përfshirë shtojcat, ose materialit mbështetës ose provave, duke përfshirë transkriptimet e referencave relevante dhe përkthimin në anglishte të tyre.

¹⁴ Shih më lart, paragrafët 13 dhe 14.

¹⁵ Shih më lart, para. 24.

3. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me përkthimet

28. Çdo mosmarrëveshje ose kundërshti sa i përket saktësisë së përkthimeve zgjidhet nga NJP-ja.

IV. VENDIM

29. Për arsyet e përmendura më lart, gjykatësi i vetëm:

- a) Përcakton që anglishtja është gjuha e punës për procedimin me numër KSC-BC-2020-07.
- b) Urdhëron cilëndo palë ose pjesëmarrës, sipas rastit, të paraqesë çdo parashtrim, shtojcë ose material mbështetës ose prova të tjera të paraqitura bashkërisht me parashtrimin në pajtim të plotë me udhëzimet e hollësishme të përcaktuara më lart; dhe
- c) urdhëron NJP-në që të informojë çdo palë dhe pjesëmarrës, sipas rastit, për kriteret e përcaktuara më lart, nëse parashtrimi, përfshirë shtojcat, ose material tjetër të paraqitur, nuk është në pajtueshmëri me udhëzimet e përcaktuara në vendim.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola

Gjykatësi i Vetëm

E enjte, 29 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.